

115-2021301
dt. 18.10.2019



Z. B. Gj. I. T.
18.10.2019

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

AGJENCIA SHTETËRORE PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Nr 381 / Prot
12

Datë 11/10 2019

KËRKESË PËR INFORMACION LIDHUR ME REALIZIMIN E TË DREJTAVE DHE MBROJTJES SË FËMIJËS

DREJTUAR: BASHKISË Delvinë

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës ka përgjegjësi për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, si dhe monitorimin e zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Gjithashtu, ASHDMF ka për detyrë të bashkëpunojë me strukturat shtetërore përgjegjëse në procesin e hartimit të propozimeve e të zbatimit të politikave integruese në Bashkimin Europian, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

Neni 44 i ligjit nr 18.2017” Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” përcakton detyrimin që kanë autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor për të bashkëpunuar me agjencinë, për shkëmbimin e informacionit, të statistikave dhe të dhënave të tjera, të kërkuara në kuadër të realizimit të veprimtarisë së saj.

Në kuadër të raportimeve ndërkombëtare për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian për çështje që lidhen me realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, kërkohet bashkëpunimi juaj për sigurimin e këtij informacioni nga institucionet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor.

Kërkohet nga ana juaj, informacion mbi programe, politika, akte nënligjore, udhëzime, protokolle, plane veprimi, fushata ndërgjegjësuese dhe çdo informacion tjetër që lidhet me arritje në fushën e realizimit të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

Informacioni duhet të pëfshijë periudhën **janar 2018- deri në tetor 2019** dhe të dërgohet me shkresë zyrtare dhe elektronikisht në adresën: info@femijet.gov.al brenda datës **21 tetor 2019**.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR
Alma Tandili